

RELACION

TEKNIK

PËR PROJEKT ZBATIMI PËR OBJEKTIN:

**RIKONSTRUKSION I RRUGËS NË VAZHDIM TË 7 PALLATEVE,
VLORË**

Projekt – zbatimi bashkangjitur, konsiston në zgjidhjen optimale për rikonstruksionin e rruges ne vazhdim te zones se 7 pallateve.

Rruga e propozuar ndodhet ne pjesen Jug-Lindore te qytetit te Vlores. Gjate viteve të fundit kjo zonë është plotësuar me ndërtesa te shumta dhe si pasoje e zhvillimit nga ndertimi i shetitores bregdetare te qytetit te Vlores. Kryesisht ne kete zone jane ndertuar banesa 2-3 kate me funksion te perzier banim-hoteleri.

Vendodhja e rruges ne lidhje me zonen



Ajo ndodhet në zonë të populluar dhe me atraksion turistik. Është rrugë e cila ka akses direkt ne zonen e Lungomares Vlore dhe i shërben nje lagjie me banesa të ndërtuara rreth viteve 90. Por vitet e fundit ka pas një zhvillim të madh turistik dhe ka lindur nevoja për përmirësimin e infrastrukturës që konsiston në asfaltimin e saj dhe vendosjen e ndricimit.



Rruga gjatë gjithë gjatësisë se saj ka terren të pjerrët ne drejtim te lindjes dhe në një pjesë të saj ka nevojë për ndërtimin e një muri mbajtës si dhe prishjen e një pjese të murit rrethues të një banese.

Gjendja ekzistuese e trupit te rruges

Gjendja ekzistuese e saj paraqitet teper e amortizuar dhe jo sipas standarteve te kerkuara te nje turizmi elitar.

Deri me sot kjo rruge eshte mirembajtur nga banoret e zones me investime rastesore.





Projekti i Propozuar




Projekti konsiston ne realizimin e nje segmenti me gjatesi prej rreth 405 ml dhe me gjeresi 5 m. Kjo rrugë fillon në afërsi të asfaltit ekzistues dhe vazhdon në një pjesë

kodrinore ku përshkruan një rrugë ekzistuese të shtruar me cakëll dhe një pjese do të bëhet hapja e rrugës së re. Këtu do të parashikohet dhe ndërtimi i një muri mbajtës i cili do të bëjë të mundur të vazhdojë rruga për ti dhëne akses dhe disa banorëve të cilët nuk e kanë të mundur aksesin në pronat e tyre. Rruga është pjesërisht në shpatin e një kanali i cili do të pastrohet dhe do të sistemohet në të gjithë pjesën e tij. Edhe ndricimi do të jetë në fokus të projektit, ku do të bëhet vendosja e shtyllave në një distancë prej 25m mes tyre.

Shtresat e trupit të rrugës janë si më poshtë:

- Shtrese Cakëlli 20 cm
- Shtrese stabilizanti 15 cm
- Shtrese binderi 6 cm
- Shtrese asfaltbetoni 4 cm



Projekti i Propozuar i Ndricimit



Rruga e cila do të rikonstruktohet do të pajiset dhe me ndricim gjatë gjithë gjatësisë së saj.

Mbas perfundimit te punimeve te ndertimit, do te kryet vijeziimi dhe konturimi i trupit te rruges

Urb Erlind Kapaj